



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2025



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i V-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2025

Më 29.X.2025

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Zahir Doda, DKA

Emrush Lalinovci, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Vedat Dema -Zyara për Barazi Gjinore

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Shemsedin Abazi-KLSP

Albestrim Rexhepi-FSK

Ekrem Livoreka- Komiteti për komunitete

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës .

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .

2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën mes dy takimeve .

3.Promovimi i përfshirjes së grupeve të marginalizuara-krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirja e komunitetit

4.Të ndryshme .

1.Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .

-Pika e parë e rendit të ditës miratohet nga të pranishmit .

2.Gjendja e sigurisë në Komunën e Kaçanikut në periudhën mes dy takimeve .

-Për gjendjen e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve raportoi Komandanti i Stacionit të Policisë z.Emrush Lalinovci.

Emrush Lalinovci – gjendja e sigurisë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile dhe nuk ka ndonjë rast që duhet veqar.Shqetësuese siq e kam cekur edhe më herët është rritja e rasteve të përdoruesve të narkotikëve.Në këtë periudhë kohore i kemi 13 raste që kanë të bëjnë me përdorues të narkotikëve që është një dukuri në rritje ,andaj apeloj për një angazhim të të gjithëve në luftimin e kësaj dukurie.

Nëpër shkolla i kemi pasur tri raste të prishjes së rendit dhe qetësisë publike të cilat raste janë përcjellë në procedurë të mëtutjeshme gjyqësore.

Për luftimin e dukurive negative nëpër shkolla i bëj thirrje institucioneve shkollore të bashkëveprojmë me aktivitete të ndryshme për parandalim.

Nëse është nevoja për informata shtesë lidhur me gjendjen e sigurisë në përgjithsi herave tjera mundem edhe të ju përgatis nga një kopje të raportit lidhur me çdo gjë që kanë ndodhur në periudhën në mes dy takimeve

Vedat Dema:më intereson të dijë për 5 rastet në shkollë që përmende të qfar natyre kanë qenë ato raste.

Emrush Lalinovci:Kryesisht janë raste të dhunës që kanë përdorë nxënësit në mes vehte.

Zahir Doda:rastet e dhunës kryesisht ndodhin jashtë ambienteve shkollore dhe organet e shkollës hapin e parë që e ndërmarrin e njoftojnë policinë.Organet drejtuese të shkollës veprojnë në bazë të kompetencave që i kanë duke i lajmruar prindërit duke i takuar ata në objekte shkollore por që nuk kemi të drejtë të ju shkojmë në shtëpi.Për këtë punë kompetent është Enti për Punë dhe Mirëqenje Sociale që rastet e tilla të i trajtojnë në bazë të punës dhe detyrave që kanë.E kam cekur edhe më herët që sidomos në zonën urbane në disa pika të jenë edhe prezenca e policisë pa uniformë zyrtare që besoj se do të ket efekt në parandalim të dukurive negative.

Emrush Lalinovci-nëse ka kërkesa shtesë nga drejtorët e shkollave, të na i drejtojnë tek ne ndërsa sa i përket patrollimit në hapsirat e jashtme shkollore dhe në disa pika urbane siq është edhe stacioni i autobusëve, policia veq se është prezent.

Zahir Doda-jemi shumë të kënaqur me bashkëpunimin që kemi pasur me policinë por që vërejtja është me Entin për Punë e Mirëqenje Sociale që sipas mendimit tim po e neglizhojnë punën e tyre apo edhe nuk është nën kompetencën e tyre trajtimi i këtyre rasteve.

Fatmir Qaka-në aktivitetet e Javës së Rinisë e organizuar nga KVRL si pjesë e axhendës ka qenë edhe një debat lidhur me dukuritë negative tek të rinjtë ku në atë debat të rinjtë shfaqën shqetësim se dukuria e përdorimit të narkotikëve , bulizmi,huliganizmi dhe dukurit tjera negative janë prezent në komunën tonë,Propozoj që të organizohet një tryezë ku do të përfshiheshin edhe të rinjtë ku do të diskutohen këto tema .

Kryetari: - një tryezë e tillë mundet me u organizu në sallën e Kuvendit dhe ne mundemi me ju bë ftesë edhe akterëve që mundë të jenë pjesë e këtij diskutimi.

Fidaim Fazliu:është ide e mirë që policia të bëjë takime me drejtort e shkollave dhe këto takime të shërbejnë për përmisim të gjendjes.E keqja është se numri i përdoruesve të narkotikëve po rritet e veprimet po mungojnë.Policia ,drejtort e shkollave por edhe nxënësit kan informacione por që këto informacione janë të pamjaftueshme.Sipas mendimit tim kjo pamjaftueshmëri e informacioneve vjen si pasojë e procedurave që ndjekë policia që nganjëher jan të lodhshme për qytetarët.Apeloj tek policia që procedurat e marrjes së informacioneve të jen më të lehta.

Për rastet e dhunës nëpër shkolla duhet që organet e shkollës të mirren më shumë me këtë dukuri duke marrë masa që i përkasin institucioneve shkollore.

OJQ-të që veprojnë në komunën tonë jan shumë selektiv ku aktivitetet e tyre i bëjnë vetëm në qytet dhe këto aktivitete nuk i shtrijnë edhe në viset rurale,andaj apeloj që këto aktivitete të shtrihen edhe në zona më të thella dhe të përfshijnë edhe pjesmarrës të cilët nuk janë përfshirë kurr nëpër aktivitete.

Dhunë e dukuri tjera negative ka edhe nëpër fshatra andaj është mirë që këto aktivitete të kenë gjithëpërfshirje.

E kam edhe një kërkesë nga komandanti i policisë që gjat raportimit të kemi shifra të çdo rasti ngase kjo ka ndodhë edhe në të kaluarën dhe kemi qenë më të informuar mbi gjendjen e sigurisë në përgjithsi.

Emrush Lalinovci-nëse dyshohet në qështjen e konfidencialitetit lirisht mundeni të thirrni në numrin tim personal e gjithashtu nuk do të thirren të ipen deklarata për të njëjtin informacion por që kuptohet se nëse informacioni është i një rëndësie të veqant atëher patjetër se do të ndjeken disa procedura për të kompletuar informacionin.

Naim Hysa-pran oborrit të shkollës në fshatin Stagovë një grup i të rinjëve mbledhen pothuajse çdo nat dhe shpesh e keqpërdorin oborrin e shkollës duke bërë gara me automjete ku për këtë rast është njoftuar edhe policia por që ky informacion nuk është marrë për bazë. Ndoshta do të ishte mirë që dyert e oborrit të shkollës të mbylleshin dhe të mos keqpërdoret kjo hapsirë.

Kryetari-oborrin e shkollave i kemi lënë të hapura me qëllim që hapsirat sportive të shfrytëzohen edhe nga komuniteti por që në rast të keqpërdorimit atëherë ne mundemi edhe me i mbyllë.

Emrush Lalinovci-ndoshta edhe është njoftuar policia por që tereni i patrollimit është shumë i madh dhe nganjëherë nuk mundemi me u përgjigj kërkesave të qytetarëve. Pasi që po thuhet se ky veprim është i përsëritshëm atëherë unë do të mirrem me këtë qëshkje.

3. Promovimi i përfshirjes së grupeve të marginalizuara-krijimi i mekanizmave të bashkëpunimit ndërinstitucional dhe përfshirja e komunitetit

Kryetari-lidhur me këtë pikë të rendit të ditës ne këtu kemi zyrtarin për Barazi Gjinore dhe OJQ-të që mund të japin kontribut në shtjellimin e kësaj teme

Vedat Dema-komuna jonë ka mekanizma të bashkëpunimit ndërinstitucional ku janë të përfshirë edhe komuniteti. KKSBB është një mekanizëm që përfshinë edhe komunitetin dhe që diskutohen tema që kanë të bëjnë me sigurinë qytetare. Gjithashtu është mekanizmi për parandalimin e dhunës në familje ku janë të përfshirë edhe komuniteti e që kanë takime të rregullta. Ky mekanizëm ka zhvilluar aktivitet të ndryshme në parandalimin e dhunës në familje kështu që shprehë falënderim për stacionin e policisë, Drejtorinë e Arsimit dhe Bashkësinë Islame për bashkëpunim në realizimin e aktiviteteve të këtij mekanizmi. Nëntori e dhjetori janë muaj që promovojnë aktivitete vetdijuese kundër dhunës në familje dhe ju kisha inkurajuar që të na bashkëngjiteni në këto aktivitete.

Nga policia është mbajtur një aktivitet lidhur me dukurinë e trafikimit me qenje njerzore dhe është mirë që aktivitete të tilla të kenë koordinim me mekanizmat përkatës që janë në komunë.

Emrush Lalinovci-për dukurinë e trafikimit me qenje njerzore është ekipi i specializuar nga regjioni dhe ne mund të jemi si urë lidhëse për komunikim dhe bashkëpunim, e sa i përket dukurisë së dhunës në familje ne kemi njësitin që mirret me këtë dukuri dhe çdo herë jemi në gadishmëri për të bashkëpunuar.

Vedat Dema-propozoj që në kuadër të aktiviteteve që priten të fillojnë këto ditë nga mekanizmi për parandalimin e dhunës në familje, të organizohet edhe një tryezë diskutimi mbi këtë dukuri ku në këtë tryezë pos akterëve institucional dhe OJQ-ve të marrin pjesë edhe përfajqsues nga rinia shkollore, përndryshe jam kundër formimit të mekanizmave tjerë pasi që të gjithë akterët janë të përfshirë në mekanizmat egzistues.

Elmihane Malsiu-grupet e marginalizuara përfshinë të gjitha kategoritë e shoqërisë dhe ideja është që të formohet një mekanizëm gjithpërfshirës ku pjesë e këtij mekanizmi do të jenë kjo kategori. Kjo mundë të bëhet me një vendim të Kryetarit të Komunës ku do të përfshihen të gjitha grupet e marginalizuara dhe ky mekanizëm të mbajë takime të rregullta dhe të diskutohen tema të ndryshme që i preokupojnë shoqërinë në përgjithsi. Qëllimi është që të përfshihet edhe komuniteti i cili mundë të jap ide në projekt të ndryshme komunale me qëllim që këto projekte të jenë të kompletuara. Nga ky takim mundë të mirret një iniciativë për formimin e këtij mekanizmi që do të ket gjithpërfshirje e gjithashtu ky mekanizëm mundë të bëjë plan veprimi i cili plan do të shërbejë në arritjen e qëllimeve të përbashkëta.

Vedat Dema-në kuadër të komunës janë disa mekanizma por që nuk janë aq edhe funksional ngase ka neglizhencë të disa akterëve për të marrë pjesë nëpër takime.

Kryetari-krijimi i mekanizmave ndoshta është diçka e tepërt por që çdo pjesë e shoqërisë për çdo projekt ka të drejtë të reagoj , të jep vërejtje e këshilla nëse mendohet se nuk është duke shkuar mirë. Tash edhe ligji e rregullon qështjen e ndërtimeve ku praqiten kriteret e paraqitura me ligj.

Fidaim Fazliu-ndoshta ideja e Elmihanit është e mirë por që në këtë aspekt shumë gjëra janë të rregulluara me ligj.

Vedat Dema-në kuadër të Kuvendit Komunal është edhe Komiteti për Komunitete dhe këto qështje mundë të ngritën edhe në këtë mekanizëm. Është për keqardhje mos prezenca e disa institucioneve nëpër takime të ndryshme që thirren nga këto mekanizma që janë në kuadër të komunës.

Emrush Lalinovci-Brengosëse është edhe mosfunksionimi i mekanizmave të sigurisë siq janë KLSP dhe EVSB të cilët janë të përfajqsuar në KKSB.

Fatmir Qaka-është e vërtetë se KLSP dhe EVSB janë jo funksional dhe pos takimeve në KKSB nuk kan ndonjë aktivitet tjetër .Kjo është si pasojë e asaj se anëtarët e këtyre dy mekanizmave shumica vijnë nga shoqëria civile po edhe nga institucionet e që puna e tyre është kryesisht vullnetare dhe që hezitojnë të humbin kohë në angazhim .Qështjen e këtyre mekanizmave duhet që institucionet të e shqyrtojnë dhe të ju ofrojnë kushte për angazhim.

4. Të ndryshme

Emrush Lalinovci-gjithësejtë i kemi pasur 75 tubime elektorale të partive politike dhe deshta të i përgëzoj të gjithë për një fushatë të qetë e pa asnjë incident e po shpresoj që edhe fushta gjat balotazhit të kaloj mirë.

Kryetari: edhe unë kisha me ju bashkangjitë komandantit me i përgëzu të gjithë partitë politike dhe qytetarët për një fushatë të qetë elektorale. Gjithashtu dshta me ju falënderu të gjithve juve këtu për angazhimin që keni tregu në KKSB ngase deri në fund të vitit është i

parapare edhe një takim të cilin nuk mundë ta dijë se a mundë të jem kryesues i këtij takimi.

REKOMANDIMET

1. Një angazhim i gjithë akterëve në parandalimin e dukurive negative në shoqëri
2. Enti për Punë dhe Mirëqenje Sociale të kryejë detyrat në kuadër të përgjegjsive që kanë ngase shumë shpesh po i neglizhojnë takimet të thirruar nga mekanizma të ndryshëm
3. Të mbahen tryeza vetdijuese mbi dukuritë negative në shoqëri ku pos mekanizmave përgjegjës të marrin pjesë edhe rinia shkollore
4. Të ndërmerren veprime konkrete në parandalimin e përdorimit të narkotikëve
5. Të lehtësohen procedurat e marrjes së informacioneve për qytetarët nga policia
6. OJQ-të të shtrijnë aktivitetet e tyre edhe në viset rurale
7. Të mirren masa ndaj atyre që keqpërdorin hapsirat e jashtme shkollore
8. Të shikohet mundësia e krijimit të një mekanizmi gjithpërfshirës ku pjesë e këtij mekanizmi të jenë edhe kategoritë e marginalizuara.
9. Të mirren masa nga institucionet përgjegjëse të sigurisë si nga niveli lokal edhe ai qendrorë në rifunksionalizimin e dy mekanizmave siq janë EVSB dhe KLSP ngase këto mekanizma kanë zbehë punën e tyre.

Kryesoi – Kryetari

h z. Besim Ilazi



Procesmbajtës

Fatmir Qaka